



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR**

**VERIFKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATES  
NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK RROGOZHINË, NË ZBATIM TË  
LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË  
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatës nga lista shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

**Nr . 182 i vendimit Data 18.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatës nga lista shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Këshilli i Bashkisë Rrogozhinë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës në Këshill për shkak të dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të njërit prej anëtarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar znj. Adelina Mezan Çeka, të cilit i takon mandati në bazë të listës shumëmemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, të znj. Adelina Mezan Çeka, rezulton se: nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2370 prot., datë 15.04.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2369 prot., datë 15.04.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidaten për anëtare në këshillin bashkiak, znj. Adelina Mezan Çeka, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. V- 1112/1 prot., datë 16.04.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidaten për anëtare në Këshillin Bashkiak Rrogozhinë, sipas të cilës rezulton se znj. Adelina Mezan Çeka, është e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar kreut V paragrafi i fundit, pikës 2, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për kandidatin për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilës nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli bashkiak përkatës dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

---

**Nr . 182 i vendimit Data 18.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidates nga lista shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

## VENDOSI:

1. Njoftimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë, për vazhdimin e procedurave, për dhënien e mandatit kandidatës të listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, znj. Adelina Mezan Çeka, për plotësimin e vendit vakant në këshillin bashkiak.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI -</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI -</b>	<b>Anëtare</b>

---

**Nr . 182 i vendimit Data 18.04.2019 e vendimit Ora 12:00 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatës nga lista shumemërore për Këshillin Bashkiak Rrogozhinë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"